



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 4 tetor 2012**

**Numri i lëndës: 2012-05**

**Fatmir Pajaziti**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 4 tetor 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 7 maj 2012.

## **II. FAKTET**

1. Më 13 shtator 2012 parashtruesi i ankesës dhe gjashtë persona të tjerë ishin akuzuar nga prokuroria speciale e Kosovës për krim të organizuar dhe trafikim të emigrantëve.
2. Aktakuza ishte vërtetuar nga gjykatësi për konfirmim i gjykatës së qarkut të Prishtinës më 20 tetor 2010.
3. Më 17 qershor 2011, trupi gjykues i përzier i EULEX-it dhe gjykatësve vendorë kanë lëshuar vendim. Parashtruesi i ankesës ishte shpallur i pafajshëm sa i përket pjesëmarrjes në krim të organizuar, mirëpo ishte shpallur fajtor sa i përket trafikimit të emigrantëve dhe ishte dënuar me shtatë vite burgim. Parashtruesi i ankesës dhe bashkë të akuzuarit kishin paraqitur ankesë kundër këtij vendimi.
4. Më 3 tetor 2012, gjykata supreme ku në përbërjen e saj ishin një trup gjykues i përzier i dy gjykatësve të EULEX-it dhe tre gjykatësve vendorë, kryesuar nga një gjykatës i EULEX-it, kanë hedhur poshtë të gjitha ankesat dhe kanë vërtetuar të gjitha dënimet me burgim.

## **III. ANKESAT**

5. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të Deklaratës së përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe të Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Përderisa nuk është përmendur ndonjë dispozitë e veçantë e këtyre dokumenteve ligjore, ankesa kuptohet se supozon se nuk ka pasur arsye për dënimin e parashtruesit të ankesës dhe se e drejta e tij që të konsiderohet i pafajshëm dhe të trajtohet si i tillë gjatë gjykimit të tij ishte shkelur nga gjykata e qarkut në Prishtinë.

## **IV. LIGJI**

6. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
7. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
8. Paneli vëren se parashtruesi i ankesës në thelb pohon se ishte dënuar padrejtësisht duke shkelur të drejtën e tij për tu konsideruar i pafajshëm.

9. Sipas rregullës 25, paragrafin 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë të shqyrtoj qoftë aspektet administrative apo juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Ato janë kompetencë vetëm e gjykatave të Kosovës. Për më tej, Paneli ka gjetur se edhe pse gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera, lëndët nga PShDNj nr. 2011-24, *Predrag Lazić*, § 20; 2011-10, *Dejan Jovanović*, § 33.).
10. Si pasojë, çështje e ngritur në këtë ankesë nuk hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Prandaj, kjo çështje nuk hyn në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se kjo ankesë është e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese